



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



R A P O R T

PËR PUNËN E KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJAKOVËS

Dhjetor 2021 – Dhjetor 2022

Gjakovë, Janar 2023

P Ë R M B A J T J A

Fjalë hyrëse

Të dhëna të përgjithshme

Përbërja e KK Gjakovë

Komiteti për Politikë dhe Financa

Komiteti për Komunitete

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Transparenca e punës së KK-së

Aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës

Puna e Kryesueses së Kuvendit Komunal të Gjakovës

Koordinimi me bashkëpunëtorët, shoqërin civile dhe aktivitetet

Komitetet dhe Komisionet tjera të Kuvendit

Përfaqësimi i anëtarve të kuvendit në komitete dhe komisione



FJALË HYRËSE

Ky Raport, ofron informacion përmbledhës për aktivitetet e Legjislaturës së (7)-të të Kuvendit të Komunës së Gjakovës. Legjislatura e (7)-të filloj punën më 06 dhjetor 2021, pas zgjedhjeve lokale për Kuvende të mbajtura me datë 17 tetor 2021, dhe me certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 16 nëntor 2021.

Kuvendi Komunal i Gjakovës ka punuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit Komunal dhe Rregullores së Punës, duke zgjedhur fillimisht organet e veta për të mundësuar funksionimin normal si institucioni më i lartë në Komunën e Gjakovës.

Kuvendi ka punuar në zbatimin rolin e tij përfaqësues dhe atë të mbikëqyrjes, e ka rritur transparencën e komunikimin dhe bashkëpunimin me institucionet qendrore, me theks të veçantë ka rritur bashkëpunimin me qytetarët dhe shoqërinë civile. Rezultate të mira janë arritur në bashkëpunimin me komunat tjera, janë pritur delegacione të ndryshme vendore dhe të huaja, dhe janë realizuar vizita të shumta nga ana e Kryesueses dhe anëtarve të Kuvendit. Transparenca e punës së Kuvendit është siguruar përmes ueb-faqes, publikimeve në rrjetet sociale, transmetimeve të drejtpërdrejta, komunikimet e hapura me publikun etj. Për përmbushjen e funksioneve të tij, Kuvendi gjatë kësaj periudhe është përkrahur nga partnerët e saj, përfshirë OSBE-në dhe të tjerë të cilët i falënderojmë për mbështetjen e tyre.

Gjakovë, më 18.01.2023

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Komuna e Gjakovës ndodhet në jugperëndim të Kosovës. Ajo mbulon një sipërfaqe prej rreth 586 km² dhe përfshin qytetin e Gjakovës dhe 91 vendbanime. Sipas regjistrimit të Popullsisë dhe ekonomive familjare të Kosovës 2011, gjithsej popullsia është 94,556. Komuna e Gjakovës ka 30 bashkësi lokale, 10 në zonën urbane dhe 20 në zonat rurale.

Në bazë të nenit 4, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (NR. 03/L-040), Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një bashkësi e qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore.

Kuvendi i Komunës së Gjakovës i ushtron kompetencat vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin. Kuvendi i komunës¹ është organi më i lartë në komunë dhe zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

Në bazë të të dhënave statistikore të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, në zgjedhjet lokale të mbajtura në vitin 2021, pjesëmarrja e qytetarëve në votime ka qenë 37.2%. Në vijim janë paraqitur të dhënat statistikore të publikuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor²:

Votuesit e Komunës së Gjakovës	
Numri i votuesve të regjistruar	113,165
Numri i votuesve të cilët kanë votuar në secilin vendvotim	40,558
Numri i votuesve të cilët kanë votuar jashtë vendvotimit	1,589
PJESËMARRJA NË VOTIME	37,2%

Lista e partive politike të përfaqësuara në KK Gjakovë:

Nr.	Emri i partisë/ koalicionit	Votat	%	Ulëse
1	(121) ALEANCA PER ARDHMERINE E KOSOVES	11 579	30,09%	11
2	(144) LEVIZJA VETEVENDOSJE!	10 829	28,14%	10
3	(177) PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES	4 911	12,76%	5
4	(160) LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVES	4 648	12,08%	4
5	(134) PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVES	4 366	11,35%	4
6	(119) NISMA SOCIALDEMOKRATE	1 435	3,73%	1

¹ LVL NR. 03/L-040, Neni 35.1

² 02.-Statistikat-sipas-komunave.pdf (kqz-ks.org)


Përbërja e Kuvendit të Komunës së Gjakovës

Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka tridhjetëepesë (35) anëtarë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në kuvend ndahen midis partive në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet e mbajtura për zgjedhjet lokale.

Nga 35 anëtarë të KK-së, të gjithë janë shqiptarë të Kosovës dhe 13 janë gra. Kryesuese e Kuvendit Komunal është, znj. Arbëneshë Kuqi (PDK). Në zgjedhjet e fundit të vitit 2021, AAK-ja fitoi zgjedhjet lokale për kryetar në raundin e dytë, në koalicion me PDK-në dhe PSHDK-në.

Në kuvendin e komunës nuk ka përfaqësim politik nga komunitetet joshumicë. Partitë më aktive të komuniteteve joshumicë në komunë janë “Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës” (IRDK) dhe “Partia Liberale Egjiptiane” (PLE), që përfaqësojnë komunitetin egjiptian të Kosovës, komunitetin më të madh joshumicë që jeton në komunë. (5,117 persona, sipas regjistrimit të vitit 2011). Të dyja partitë nuk arritën të hyjnë në kuvendin e komunës në zgjedhjet lokale të vitit 2021. Për më tepër, në komunë ekzistojnë degë të partive politike që përfaqësojnë komunitetet tjera joshumicë, përkatësisht “Lëvizja Progresive Rome e Kosovës” (LPRK) dhe “Partia e Bashkuar Rome e Kosovës” (PREBK) dhe “Partia Ashkali për Integrim”. (PAI).

PËRBËRJA PARTIAKE E KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJAKOVËS



Emrat e anëtarve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës³:

Përkatësia Politike	Emri	Mbiemri	Gjinia
ALEANCA PER ARDHMERINE E KOSOVES	VALON	PNISHI	M
ALEANCA PER ARDHMERINE E KOSOVES	SHPEND	BAJRAMI	M
ALEANCA PER ARDHMERINE E KOSOVES	BESIM	KADRIJA	M
ALEANCA PER ARDHMERINE E KOSOVES	AGUSTIN	SHALA	M
ALEANCA PER ARDHMERINE E KOSOVES	NIK	HISENI	M
ALEANCA PER ARDHMERINE E KOSOVES	ALBINA	SADRIJA- ASLLANI	F
ALEANCA PER ARDHMERINE E KOSOVES	HIM	ZEQA	M
ALEANCA PER ARDHMERINE E KOSOVES	HEKURAN	HOXHA	M
ALEANCA PER ARDHMERINE E KOSOVES	TEUTA	PALLASKA MILLA	F
ALEANCA PER ARDHMERINE E KOSOVES	ALBULENA	ZUKA-VOKSHI	F
ALEANCA PER ARDHMERINE E KOSOVES	ERMIRA	MEHMETI	F
LEVIZJA VETEVENDOSJE!	NGADHNJIM	DANA	M
LEVIZJA VETEVENDOSJE!	MIMOZA	SHALA	F
LEVIZJA VETEVENDOSJE!	LEDIAN	REXHA	M
LEVIZJA VETEVENDOSJE!	ALI	TAFARSHIKU	M
LEVIZJA VETEVENDOSJE!	MUSTAFA	DOMI	M
LEVIZJA VETEVENDOSJE!	AGON	DOBRUNA	M
LEVIZJA VETEVENDOSJE!	KRESHNIK	ALIJAJ	M
LEVIZJA VETEVENDOSJE!	ERMAL	KUSARI	M
LEVIZJA VETEVENDOSJE!	DIANA	QARKAXHIJA	F
LEVIZJA VETEVENDOSJE!	SHQIPE	FEJZA	F
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES	ARBENESHA	KUQI	F
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES	BASHKIM	GASHAJ	M
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES	LABEHAT	SADRIJA	M
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES	LIRIANDA	DAHSYLA	F
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES	LIRIDON	DULA	M
PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVES	BESIM	NDAU	M
PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVES	ROBERT	MARKAJ	M
PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVES	LERENA	KAMERAJ	F
PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVES	KRENARE	BUSHAJ	F
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVES	TEKI	SHALA	M
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVES	NEXHDET	MORINA	M
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVES	SARANDA	HODA	F
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVES	BESARTA	LEKAJ	F
NISMA SOCIALDEMOKRATE	FAZLI	HOXHA	M

³ » [Asambleistët / këshilltarët \(rks-gov.net\)](http://Asambleistet/keshilltaret/rks-gov.net)

GRUPET E ANËTARËVE TË KUVENDIT

“Grupi i anëtarëve” nënkupton një grup që përbëhet prej së paku dy (2) anëtarëve të Kuvendit që udhëhiqet nga Shefi/ja i/e grupit i/e emëruar nga vet anëtarët e atij grupi kuvendar. Në KK Gjakovë janë pesë (5) grupe të anëtarëve të kuvendit, që udhëhiqen nga:

1. AAK - Nik Hiseni
2. LVV – Mimoza Shala
3. PDK – Labehat Sadrija
4. LDK – Teki Shala
5. PSHDK – Krenare Bushaj

Mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës dhe zgjedhja e organeve

- Mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës dhe dhënia e betimit të anëtarëve është mbajtur më 06 dhjetor 2021;
- Zgjedhja e Kryesueses të Kuvendit, është bërë më 06.12.2021;
- Komitetet obligative (Komiteti për Politikë dhe Financa është formuar me datë 10.12.2021 dhe Komiteti për Komunitete është formuar më datë 07.02.2022)

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

MBLEDHJET E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA (KPF)

Në mbledhjen e datës 07.02.2022, KK Gjakovë ka miratuar planin e punës, dhe ka filluar me takimet e rregullta të KPF-së. Sipas planit të punës, takimet e KPF-së janë mbajtur të enjten e dytë të çdo muaji, ndërsa mbledhjet e kuvendit të enjten e fundit të muajit.

Mbledhjen e parë e ka mbajtur më 26.01.2022. Gjatë punës së vetë, KPF-ja ka zbatuar rregullat dhe procedurat e parapara me LVL-në dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, me rastin e shqyrtimit të propozimeve, shqyrtimit të çështjeve të parashtruara, po ashtu edhe gjatë hartimit të raporteve dhe rekomandimeve për Kuvendin.

Janë mbajtur gjithësejtë 10 mbledhje të KPF-së dhe janë nxjerrë 58 rekomandime për shqyrtim në mbledhjet e Kuvendit Komunal. KPF-ja ka shqyrtuar 4 raporte periodike financiare të buxhetit të komunal.

Përbërja dhe struktura:

1.	Arbënesha Kuqi	PDK	Kryesuese
2.	Albina Sadrija - Asllani	AAK	Anëtare
3.	Teuta Pallaska - Milla	AAK	Anëtare
4.	Augustin Shala	AAK	Anëtar
5.	Mimoza Shala	LVV	Anëtare
6.	Ali Tafarshiku	LVV	Anëtar
7.	Labeat Sadrija	PDK	Anëtar
8.	Teki Shala	LDK	Anëtar
9.	Krenare Bushaj	PSHDK	Anëtare



Në KPF ka mbizotëruar një frymë kolegjiale, është punuar me seriozitet dhe profesionalizëm, ku për çështje përmbajtjesore ka pasur konsensus në marrjen e vendimeve të cilat janë rekomanduar tutje për shqyrtim nga Kuvendi Komunal. Mbledhjet e KPF-së kanë qenë publike dhe janë vëzhguar nga përfaqësues të OSBE-së, organizata të shoqërisë civile, si dhe nga media, përfshirë gazetarë nga Radio Gjakova dhe TV Syri Vision.

KOMITETI PËR KOMUNITETE

Në mbledhjen e parë të datës 7/02/2022, KK Gjakovë ka themeluar Komitetin për Komunitete. Ky komitet ka mbajtur mbledhjen e parë me datë 21.02.2022, në të cilën mbledhje ka zgjedhur kryesuesin e saj Z. Ergit Qeli dhe me datë 28.03.2022 ka miratuar planin e punës.

Në kuadër të fushëveprimit të tij të punës dhe përgjegjësi që i ka, shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Përbërja dhe struktura

1.	Ergit Qeli	Egjiptian	Kryesues
2.	Nik Hiseni	AAK	Anëtar
3.	Lirianda Dahsyla	PDK	Anëtare
4.	Shqipe Fejza - Daija	LVV	Anëtare
5.	Lorena Kameraj	PSHDK	Anëtare
6.	Ermira Morina	Egjiptiane	Anëtare
7.	Ifeta Jakupi	Boshnjake	Anëtare
8.	Leotrim Balaj	Ashkalinjë	Anëtar
9.	Emrah Cërmjani	Rom	Anëtar



Pjesëmarrja e anëtarve të Kuvendit në punën e komitetit për komunitete ka qenë në nivel profesional duke kontribuar në çështjet e rëndësishme. Me ftesë të komitetit, në punën e tij kanë marrë pjesë dhe kanë dhënë kontributin e tyre përfaqësuesit e ekzekutivit dhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare.

Mbledhjet e komitetit kanë qenë të hapura për publikun. Punën e komitetit e kanë përcjellë përfaqësuesit e OSBE-së, UN-it, asociacioneve dhe organizatave tjera, si dhe media lokale.

MBLEDHJET E KUVENDIT KOMUNAL **Vendimet e miratuara dhe aktet e tjera**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në Dhjetor të vitit 2021 ka mbajtur (1) mbledhje inaguruese dhe (1) të jashtëzakonshme, gjatë periudhës (Janar - Dhjetor 2022) ka mbajtur (11) mbledhje të rregullta dhe (1) mbledhje të jashtëzakonshme, në të cilat janë shqyrtuar në Kuvend dhe janë miratuar 85 akte; 77 vendime; 4 rregullore; 1 statutin e Komunës së Gjakovës dhe 1 deklaratë.

Transparenca e punës së Kuvendit Komunal të Gjakovës

Mbledhjet e Kuvendit Komunal të Gjakovës kanë qenë publike dhe janë mbikëqyrur nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare, vendore e ndërkombëtare. Punën e Kuvendit e kanë vëzhguar përfaqësuesit e OSBE-së, MAPL, asociacione dhe organizata të tjera. Po ashtu, puna e Kuvendit ka pasur hapësirë të mjaftueshme edhe në media lokale dhe qendrore.

Në realizimin e punës së vet, Kuvendi është mbështetur nga partnerë dhe ekspertë të ndryshëm. *Kuvendi shpreh falënderim të posaçëm për OSBE-në*, që kanë ndihmuar Kuvendin me ngritje të kapaciteteve dhe po ashtu për ndihmën e dhënë në përpilimin e rregulloreve, organizimin e aktiviteteve, debateve me publikun, etj.

Duke i marrë parasysh aktivitetet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe, Kuvendi ka arritur në masën më të madhe të përmbush Planin e punës të Legjislaturës së 7 (shtatë).

Gjatë vitit 2022, Kuvendi ka mbajtur (13) dëgjime publike lidhur me Rregulloren e Punës, Kornizën Afatëmesme Buxhetore, Buxhetin Komunal.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), është njëra nga organizatat kryesore e cila mbështet punën e Kuvendit që nga viti 2000. Mbështetja e OSBE-së nga aspekti i organizimit është i përhershëm në sferën e shqyrtimit të rregulloreve, mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, organizimit të dëgjimeve publike dhe tryezave të rrumbullakëta, si dhe bashkëpunimit ndërkomunal. OSBE-ja ka ofruar një numër të madh

ekspertësh në ngritjen e kapaciteteve, nga lëmia e të drejtave të njeriut dhe fusha tjera në përputhje me legjislacionin vendor dhe parimet e demokracisë.

Detyrat e Kryesueses së Kuvendit Komunal të Gjakovës

1. Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të Komunës së Gjakovës në përputhje me Ligjin 03/L – 040 dhe Statutin e Komunës, thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Mbledhjet e kuvendit të komunës dhe të KPF-së caktohen në bazë të planit të punës së kuvendit.
3. Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe të KPF-së thirren së paku shtatë (7) ditë pune para çdo mbledhje siç është e paraparë me LVL.
4. Kryesuesi/ja, përmes Shërbimit Profesional për Punë të Kuvendit, përgatit njoftimin publik për mbledhjen dhe përmes zyrës për informim, shpallë njoftimin për mbledhjet me këto të dhëna: kohën, datën, vendin dhe rendin e ditës që propozohet për punën e mbledhjes.
5. Kryesuesi/ja zhvillon takime dhe konsultime të brendshme me partit politike në Kuvend, me pjesëtarët e ekzekutivit komunal, si dhe merr pjesë në aktivitete të tjera komunale ose rajonale.

Aktivitetet e Kryesueses së Kuvendit Komunal

Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Gjakovës, gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar shumë takime zyrtare: takimet me qytetarë; takimet zyrtare me homologet e komunave tjera ; takime me organizata ndërkombëtare; NDI, Fondacioni 'Jahjaga', OSBE, USAID, DEMOS, YMCA, AKK ku Kryesuesja znj. Arbënesha Kuqi është zgjedh zëvendës kryesuese; takimet me UBSHR; takimet me institucionin e avokatit të popullit; etj dhe ka qenë pjesëmarrëse në aktivitete të ndryshme; aktivitetet për 8 mars (ditën e gruas); aktivitetet për ditën e vajzave (11 tetor); aktivitetet për ditën ndërkombëtare të rinisë (12 gusht), aktivitetet për ditën e çlirimit (14 qershor), aktivitetet për ditën ndërkombëtare të gjuhës së romëve (14 nëntor), ditët e festave fetare etj.

Me iniciativë të Kryesueses, përkrahur nga Zyrtarja Komunale për Barazi Gjinore dhe OSBE, është formuar Grupi (jo-formal) i Grave të Kuvendit i përbërë nga 13 anëtare. Grupi jo formal i grave në takimin e parë ka bërë plotësim ndryshimin e rregullores së grupit të grave dhe ka zgjedhur Kryesuesen e këtij grupi znj. Lirianda Dahsyla. Ndër aktivitetet kryesore të GJK-së kanë qenë: me datën 8 mars vizita në Shtëpinë e Sigurt, ka mbajtur takime jo formale edhe me organizata të ndryshme të cilat kanë mundësuar vetëdijesimin dhe angazhimin në çështje të sigurisë së gruas në shoqëri, ka vizituar grupin e grave pensioniste, ka marrë pjesë në Akademinë Politike për gratë politike në nivelin lokal, ka mbajtur takim në Kryqin e kuq ku secila prej anëtarëve ka ndarë pako me veshmbathje dhe ushqim për këtë organizatë e shumë aktivitete të tjera.

KOMITETET DHE KOMISIONET TJERA KOMUNALE

Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka marr vendim për themelimin komiteve:

1. Komiteti për Barazi Gjinore – vendim i datës 29.04.2022, ka mbajtur 2 takime.
2. Komiteti për Shërbime Publike – vendim i datës 29.04.2022, ka mbajtur 1 takim.

3. Komiteti për Kulturë, Rini, Turizëm dhe Trashëgimi Kulturore – vendim i datës 24.11.2022, ka mbajtur 1 takim.
4. Komiteti Konsultativ për Arsim - vendim i datës 28.07.2022, ka mbajtur 3 takime.
5. Komiteti Konsultativ për Shëndetësi – vendim i datës 28.07.2022, ka mbajtur 3 takime.

Nga mandati i kaluar është aktiv edhe komiteti konsultativ për persona me aftësi të kufizuara i cili ka mbajtur gjithsej 5 takime.

Komitetet dhe komisionet procedojnë çështjet përkitazi me natyrën e përgjegjësisë dhe çështje të tjera të fushëveprimit të tyre, dhe ia rekomandojnë Kuvendit çështjet ose punët që u janë ngarkuar, dhe i raportojnë Kuvendit Komunal të Gjakovës.

Përfaqësimi i anëtarve të kuvendit në komitete dhe komisione

Bazuar në numrin e përgjithshëm të pozitave (anëtarëve) të KK Gjakovë, anëtarët kanë pasur këtë përfaqësim nëpër komitete dhe komisione të shprehur në numër:

1. Grupi i anëtarve të AAK-së	= 7 pozita
2. Grupi i anëtarve të PDK-së	= 6 pozita
3. Grupi i anëtarve të PSHDK-së	= 4 pozita
4. Grupi i anëtarve të LVV-së	= 6 pozita
5. Grupi i anëtarve të LDK-së	= 4 pozita
6. Anëtari i NISMA-s	= 1 pozitë

Në bazë të legjislacionit në fuqi janë themeluar edhe disa komisione ad-hoc si: Komisioni për hartimin e draft statutit, komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër në kohëzgjatje prej 1 viti të pronës komunale “Tregu në Orize”, komisioni për zgjedhjen e këshillave lokale, paneli përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të komitetit konsultativ për shëndetësi, paneli përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të komitetit konsultativ për arsim, komisioni për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores së punës së kuvendit, komisioni për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale. Gjatë kësaj periudhe këto komitete dhe komisione kanë organizuar mbledhje të rregullta dhe i kanë përmbushur të gjitha obligimet për të cilat janë themeluar.



 Arbëneshja Kuqi

 Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës